



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 12.12.2017

PËR

NDRYSHIMIN E TRETË TË LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE (LEJES SË ZHVILLIMIT DHE LEJES SË NDËRTIMIT) PËR PROJEKTIN E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 116/2013, datë 15.04.2013 “Për ratifikimin e Marrëveshjes me Qeverinë e Vendit Pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të tretë të Lejes Zhvillimore Komplekse (Lejes së Zhvillimit dhe Lejes së Ndërtimit), të miratuar me vendimin e KKT-së Nr. 1, datë 08.04.2014 “Për miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për Gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP)”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, datë 08.04.2014, të ndryshuar, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**MINISTËR I LINJËS**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**DAMIAN GJIKNURI**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**

